



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna – Municipality  
Hani i Elezit



05/ Nr. 1684 / 2023

Në bazë të Rregullorës për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.01/2821/2022 të datës 31.05.2022 neni 14 pika 14.1.1 dhe neni 15 dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01/Nr.234/2022 të datës 27.01.2022 për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët e Komunës së Hanit të Elezit, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpallë:

### KONKURS

#### PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

##### Kushtet për aplikim:

- Të jenë banorë të Komunës së Hanit të Elezit;
- Të jenë student/e të Universitetit Publik të Kosovës;
- Të jenë student/e të Universitetit Publik të Maqedonisë Veriore;
- Të jenë student/e të rregullt, por jo me vetëfinancim;
- Të kenë të regjistruar vitin akademik;
- Studenti/ja nëse një herë ka përsëritur vitin, humbë të drejtën e bursës (vlenë për gjitha vitet);
- Studenti/ja i cili ka qenë përfitues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfitues i bursës për fakultetin e dytë;
- Studenti/ja nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejtë aplikimi për bursë;

##### **Prioritetet për kuadro deficitare janë Fakultetet:**

- Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci).**  
**Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).**
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).**
- Fakulteti i Edukimit (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe Teknologji me TIK)**
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).**
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Veterinari, Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Bioteknologji Ushqimore).**  
**Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).**
- Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Shkenca Kompjuterike)**
- Fakulteti i Arteve**
- Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).**

### **Dokumentet e nevojshme për konkurim;**

- a) Çertifikata e notave (me vulë origjinale)
- b) Vërtetimi i semestrit se studenti ka regjistruar vitin akademik 2022/2023(me vulë origjinale);
- c) Fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat);
- d) Deklarata e bashkësisë familjare;
- e) Çertifikatën e vendbanimit;
- f) Dëshmia se është; invalidit të luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale;
- g) Studentë që janë invalid të luftës, anëtarë të familjes së dëshmorit, invalidit të luftës, veteranit të luftës, martirët e luftës, me gjendje të rëndë sociale,student me aftësi të kufizuara duhet të sjellin dëshmitë nga shoqatat libeza dhe instucionet përkatëse;
- h) Diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit;
- i) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës;
- j) Kopjen e letërnjoftimit dhe
- k) Vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale);

### **Afati dhe mënyra e aplikimit;**

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit (kati i parë) nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.

Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej datës **28.02.2023** deri më datën **15.03.2023**

### **Sqarim shtesë:**

- a) Për bursë kanë **prioritet studentët e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores Nr.01/2821/2022 do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**
- b) Në rast se nuk plotësohet me studentet nga Maqedonia Veriore me lëndë deficitare do të plotësohen me studentët nga Universitetet Publike të Kosovës me prioritet për kadro deficitare.

**Vërejtje:** Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriteve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

